



## Titulli i projektit

Shërbimi i integruar i mbledhjes, grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane (Bashkia Klos)

## Tipi i projektit

Shërbimet Publike

## Vendndodhja e projektit

Klos, Suç, Xibër, Gurrë

## Buxheti i paravlerësuar

900,000 lekë  
+ Pjesën e investimeve të specifikuar nga Studimi

## Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Në situatën e re të dalë nga shkrija dhe bashkimi i njësjive të qeverisjes lokale në njësi më të mëdha, ofrimi i shërbimeve publike efektive pritet të jetë një prej rrjedhojave bazë të synuara. Ruajtja e stadi të arritur në shërbimet aktuale dhe përmirësimi i mëtejshëm, janë tendenca që duhet të ecin paralelisht. Shërbimi i mbledhjes së mbetjeve urbane është i organizuar aktualisht vetëm në Klos (30% e popullatës) dhe Suç (80% e popullatës). Ish-komunat e tjera nuk e ofrojnë këtë shërbim, i cili është i nevojshëm për të përmirësuar cilësinë e jetesës së qytetarëve dhe përmirësuar perspektivat e zhvillimit ekonomik, për sa kohë këto të jenë të lidhura me cilësinë e një mjedisi më të pastër. Krijimi i një sistemi të integruar të mbledhjes dhe manaxhimit të mbetjeve urbane mund të behet më cilësor dhe efektiv në kushtet e rritjes së sipërfaqes nën mbikqyrjen e Bashkisë Klos. Kostot e shërbimit do të ishin më të ulëta dhe për rrjedhojë do të ulëshin edhe tarifat e shërbimit.

## Qëllimi/et specifik të projektit

Krijimi i një sistemi të integruar të mbledhjes, grumbullimit dhe manaxhimit të mbetjeve urbane për qytetarët dhe banorët e Bashkisë Klos dhe të rrethinave.

## Rezultatet e pritshme dhe treguesit

- Rritja e efektivitetit të shërbimit të mbledhjes dhe përpunimit të mbetjeve urbane për qytetarët e bashkisë Klos dhe rrethinave (totali i popullsisë më tepër se 16000 banorë, përqindja e mbulimit me shërbim mbi 75% në fund të projektit);
- Krijimi i vend-depozitimeve cilësore për të gjitha territoret nën autoritetin e Bashkisë Klos (4 vend-depozitime);
- Krijimi i një sistemi të llogaritjes së kostos së shërbimit të integruar (kosto për banor dhe si pasojë tarifë e njëjtë për të gjithë banorët e mbuluar me shërbim);
- Memorandum bashkëpunimi me njësitë e tjera rajonale për krijimin e një vend-depozitimi rajonal të përpunimit të mbetjeve.



## Aktivitetet e projektit

- Studimi për sistemin e integruar të mbledhjes dhe depozitimit të mbetjeve urbane në Bashkinë e Klosit dhe kostimi i komponentëve.
- Aprovimi në Këshillin Bashkiak dhe hapja e prokurimit për investimet dhe shërbimin. Aprovimi i tarifës së shërbimit, si pjesë e paketës fiskale të aplikuar nga Bashkia dhe përfshirja e të ardhurave/shpenzimeve në planin/zbatimin e buxhetit bashkiak.
- Projekt-memorandumi i hartuar dhe i diskutuar për ndërtimin e vend-depozitimit rajonal të përpunimit të mbetjeve.
- Përzgjedhja e fituesit për investimin, kontraktimi dhe organizimi i shërbimit nga Bashkia, ose nga nënkontraktori.
- Zhvillimi i materialeve promociionale për promovimin dhe modalitetet e shërbimit (fletëpalosje)

## Maturimi i projektit

Ka një praktikë ekzistuese në Bashkinë e Klosit dhe në Suç për ofrimin e këtij shërbimi. Kjo praktikë duhet të shtrihet në bashkitë e tjera që do të shkrimen në kuadrin e njësisë së re Klos.

Ekziston një projekt pilot i zhvilluar nga programi dldp për njësitë e qeverisje lokale Shkodër dhe Lezhë, që mund të zhvillohet dhe zbatohet në këto zona.

Ka një projekt të mbështetur nga BE në nivel rajonal për krijimin e vend-depozitimit (Qarku Dibër), i cili mund të lehtësojë procesin e përgatitjes dhe nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit me NJQV e tjera për të minimizuar kostot.

## Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

### Burimet e Financimit:

- Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
- Transferta e Pakushtëzuar
- Të ardhurat e veta nga tarifa
- Donatorët
- Fondi i Mbështetjes së Decentralizimit

### Partnerët:

- Bashkia Mat
- Qeveria Qëndrore dhe Këshilli i Qarkut
- Donatorë: UNDP, OSBE, BE, BERZH

## Kostot e projektit

Studimi për sistemin e integruar të mbledhjes dhe depozitimit të mbetjeve urbane në Bashkinë e Klosit dhe kostimi i komponentëve 800,000

Zhvillimi i materialeve promociionale (2000 copë) 100,000

Investimi në vend-depozitime dhe pajisje për kryerjen e shërbimit

Në varësi të Studimit

Total: 900,000

(plus pjesën e investimeve të specifikuar nga Studimi)